



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/06

Datë: 17.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/06  
Datë: 17.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4), si dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, si dhe pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 17 qershor 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për aprovimin e kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë**

1. Të gjitha Institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës obligohen të organizojnë punën me stafin e tyre (në distancë fizike apo nga shtëpitë e tyre/online) në funksion të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive bazuar në legjislacionin në fuqi;
2. Të gjitha Institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës obligohen të shtojnë kontrollë rigorozë të bartjes së maskave në hyrje të çdo institucioni.
3. Të gjitha Institucionet publike dhe private në Republikën e Kosovës obligohen të organizojnë punën me stafin e tyre në përputhje të plotë me Manualin për mbrojtjen nga përhapja e virusit Covid 19;
4. Obligohen institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Inspektoratet relevante të ndër marrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi;
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Duke pasur parasysh se në javën e fundit kemi rritje të rasteve pozitive, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Avdullah HOTI**

---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë